



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 124, datë 25.11.2013

**PËR HEQJEN E MIRATIMIT TË SHOQËRISË “EASY TRADE CONSULTING”
SH.P.K., PËR TË VEPRUAR SI AGJENT I BROKERIT TË LICENCUAR TË
LETRAVE ME VLERË.**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, pikës 13 të Vendimit të Bordit të AMF-së nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, si dhe Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit, si edhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Me Vendimin e Bordit të AMF-së nr. 82, datë 22.06.2012, shoqëria “Easy Trade Consulting” ka marrë miratimin për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë, “FOREX CAPITAL MARKET LTD”.

Gjatë mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarisë së kësaj shoqërie, Autoriteti është vënë në dijeni se shoqëria “Easy Trade Consulting” sh.p.k., e miratuar për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë, “FOREX CAPITAL MARKET LTD”, ka shkelur dispozitat e vendimit të Bordit të AMF-së nr. 55, datë 30.03.2011.

Konkretisht Shoqëria:

- nuk përmbush më kushtet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të Vendimit nr. 55, datë 30.03.2011 të AMF-së;
- nuk ka raportuar në përputhje me kërkesat e pikës 12 të Vendimit nr. 55, datë 30.03.2011.

Gjithashtu, me Vendimin e datës 26.04.2013 të Asamblesë së Ortakëve është vendosur pezullimi i përkohshëm i aktivitetit të shoqërisë nga kjo datë deri në një moment të përshtatshëm për rifillimin e saj për një periudhë të papërcaktuar. Nga data 26.04.2013, Statusi i shoqërisë në QKR është “pezull”, pra shoqëria nuk kryen aktivitet.

Autoriteti ka njoftuar shoqërinë “Easy Trade Consulting” sh.p.k. mbi shkeljet e evidentuara por njoftimi është kthyer pasi shoqëria nuk rezulton të jetë në adresën e regjistruar.

Për sa më sipër, bazuar në vendimin Nr. 55, datë 30.03.2011 të Bordit të AMF-së dhe në Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. T’i heqë shoqërisë “Easy Trade Consulting” sh.p.k., të drejtën për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë “Forex Capital Market LTD”.
2. Vendimi i Bordit të AMF-së nr. 82, datë 22.06.2012, “Për miratimin e shoqërisë “Easy Trade Consulting” sh.p.k., për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë “Forex Capital Market LTD”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI